

UNIVERSITETI I TETOVËS
УНИВЕРЗИТЕТ ВО ТЕТОВО
UNIVERSITY OF TETOVA



Zyrës së doktoratave të Universitetit të Tetovës
Këshilli mësimor-shkencor i Fakultetit Pedagogjik të Universitetit të Tetovës

Këshilli mësimor-shkencor i Fakultetit Pedagogjik të Universitetit të Tetovës, në mbledhjen e mbajtur më datë 18.05.2023, solli Vendim për formimin e Komisionit për vlerësimin shkencor dhe profesional të dorëshkrimit të temës së doktoratës, me titull “Sistemi i vlerësimit të nxënësve në Kosovë sipas kurrikulës bazuar në objektiva dhe në kompetenca”, të kandidatit Hysen Balaj.

Në bazë të vendimit nr. 24-458/1, të datës 18.05.2023, Komisioni në përbërje: Prof. Dr. Lulzim Mehmedi (kryetar), Prof. Dr. Besa Havziu-Ismaili, Prof. Dr. Svetlana Pandiloska-Grnçarovska, Prof.dr. Buniamin Memedi (anëtarë) dhe Prof. Dr. Fadbi Osmani (mentor), pasi lexoi materialin në dorëshkrim, Këshillit mësimor-shkencor të Fakultetit Pedagogjik i paraqet këtë

R A P O R T

për vlerësimin e disertacionit të doktoratës

Të dhënat biografike të kandidatit:

Mr. sc. Hysen Balaj është lindur më 01 shkurt 1969, në Deçan të Kosovës, ku ka kryer shkollimin fillor dhe të mesëm, si dhe ciklin e parë dhe të dytë të studimeve të magjistraturës.

Studimet themelore fillimisht i ka përfunduar në qershor të vitit 1996 në Universitetin e Prishtinës SHLP “Bajram Curri” - Gjakovë, dhe fitoi titullin arsimtar i mësimit klasor, ndërsa në korrik të vitit 2005 ka përfunduar studimet bachelor në programin fillor të Universitetit të Prishtinës, Fakulteti i Edukimit Gjakovë dhe fitoi titullin bachelor programi fillor.

Pas kryerjes së studimeve themelore, kandidati Hysen Balaj në nëntor të vitit 2007 mbaron studimet e magjistraturës, dhe fiton titullin Master – Menaxhimi në arsim në Universitetin e Prishtinës, në Fakultetin Filozofik – Departamentin e Pedagogjisë.

Në vitin akademik 2018/19 regjistron studimet e doktoratës në Universitetin e Tetovës, në Fakultetin Pedagogjik, me temë **“Sistemi i vlerësimit të nxënësve në Kosovë sipas kurrikulës bazuar në objektiva dhe në kompetenca”** të miratuar me datë 18.05.2023, me numër 24-458/1, nga Këshilli Mësimore Shkencor i Fakultetit Pedagogjik, nën udhëheqjen e Prof. dr. Fadbi Osmani, mentor i kandidatit.

Në karrierën profesionale Mr.sc. Hysen Balaj për dymbëdhjetë vite ka punuar si mësimdhënës, dymbëdhjetë vite si drejtor shkolle, shtatë vite bashkëpunëtor i jashtëm në Fakultetin e Edukimit në Prishtinë, si dhe dy vite në Prizren. Ai ka ndjekur gjithashtu trajnime të shumta për zhvillim profesional, ka marrë pjesë edhe në grupin punues për hartimin e kurrikulave të reja në fushën e shkencave, ka qenë Anëtarë i Bordit të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve, Koordinator nga DKA- Deçan për programin Pisa 2015 me zyrën për Vlerësim dhe Standarde në MASHT, Kryetar i komisionit për hartimin e Planit Zhvillimor të Arsimit në komunën e Deçanit dhe Ekspert i jashtëm në MASHT- për barazi gjinore.

Deri më tani, Mr. sc. Hysen Balaj në cilësi të bashkautorit ka botuar dy punimet shkencore në revista ndërkombëtare shkencore. Punimi i parë, u botua në revistën General Management - Associated and Indexed: SCOPUS , “Management of quality assurance in the education of Kosovo through the evaluation process of technical performance”. Vol. 24, No. 193. Published: March 2023. https://admin.calitatea.ro/assets/Documents/Archive/PDF/20230210_6ee2934e-0a97-42dd-bc74-f945b70031dc.pdf

Punimi i dytë, u botua në revistën Journal of Pharmaceutical Negative Results - Associated and Indexed: SCOPUS, “Self-assessment As a Mechanism for Raising the Quality of Educational Institutions, Especially Evaluation of the Performance of Teachers” Vol. 14 SPECIAL ISSUE 01

Pasqyrë e aktiviteteve të realizuara nga kandidati gjatë studimeve të doktoratës:

Gjatë kësaj periudhe të studimeve të doktoratës kandidati Hysen Balaj i ka kryer me sukses provimet e doktoratës. Që nga fillimi i studimeve në ciklin e tretë e deri më sot kandidati ka dëshmuar interes dhe progres të kënaqshëm në fushën e hulumtimit dhe të punimit të temës. Ai me sukses ka realizuar tre konferencat doktorate, gjatë të cilave ka prezantuar rezultatet e hulumtimit. Gjatë kësaj periudhe ka botuar disa artikuj shkencor.

Analizë e punimit: “Sistemi i vlerësimit të nxënësve në Kosovë sipas kurrikulës bazuar në objektiva dhe në kompetenca”

Në disertacionin e tij të doktoratës me titull “Sistemi i vlerësimit të nxënësve në Kosovë sipas kurrikulës bazuar në objektiva dhe në kompetenca”, kandidati është përpjekur të analizojë gjendjen ekzistuese, të paraqesë një pasqyrë të plotë të sistemit të vlerësimit të nxënësve në Kosovë sipas kurrikulës bazuar në objektiva dhe në kompetenca. Nëpërmjet këtij studimi, kandidati është përpjekur të bëjë krahasimin e qëndrimeve të mësimdhënësve të cilët japin mësim në klasat I-IX të shkollave fillore dhe të mesme të ulët, drejtorëve të shkollave fillore dhe të mesme të ulët, pedagogëve, psikologëve, inspektorëve të arsimit dhe ekspertëve të fushës së kurrikulës.

Kapitulli i parë ofron si kornizën teorike për studimin, ashtu edhe një përmbledhje të plotë të literaturës. Kjo përfshin të nxënësve dhe teorinë e të nxënësve në kontekst të vlerësimit të nxënësve, kurrikulën bazuar në objektiva dhe ajo në kompetenca në Kosovë duke i shqyrtuar edhe dallimet në mes tyre, kontekstin praktik dhe procesin e vlerësimit sipas kurrikulës bazuar në objektiva dhe në kompetenca. Kandidati trajton edhe parimet kryesore të vlerësimit, vlerësimin e njohurive të nxënësve bazuar në objektiva dhe kompetenca, kompetencat e mësimdhënësve për vlerësimin, planifikimin e vlerësimit të nxënësve si dhe krahasimin në mes vlerësimit tradicional dhe vlerësimit bazuar në kompetenca.

Kapitulli i dytë, ofron strukturën e sistemit të arsimit parauniversitar në Kosovë sipas Kornizës së Kurrikulës bazuar në objektiva dhe kompetenca, objektivat dhe rezultatet e parapara për nivelet e ndryshme formale sipas kurrikulës 2001 bazuar në objektiva, vlerësimin e nxënësve sipas kurrikulës 2001 bazuar në objektiva, vlerësimin e brendshëm dhe të jashtëm, vlerësimin me notë dhe performancën e pranuar, strukturën e sistemit parauniversitar sipas Kornizës së Kurrikulës 2016 bazuar në kompetenca, strukturën e arsimit parauniversitar - nivelet formale dhe shkallët kryesore të Kurrikulës, fushat e kurrikulës, lëndët dhe modulet mësimore, përzgjedhjen e metodave, teknikave dhe instrumenteve të vlerësimit.

Kapitulli i tretë, ofron një shpjegim të bazës së hulumtimit në këtë studim. Një shpjegim i problemit të hulumtimit, qëllimit, objektivave dhe pyetjeve, hipotezave dhe variablave të hulumtimit. Në këtë kapitull janë dhënë edhe të dhëna mbi popullacionin dhe mostrën, metodat dhe instrumentet e hulumtimit, përpunimin statistikor të të dhënave, besueshmërinë, etikën dhe kufizimet e hulumtimit. Në hulumtimin sasior janë përfshirë 754 mësimdhënës, prej tyre 515 femra dhe 239 meshkuj nga Prishtina, Ferizaji, Gjakova, Gjilani, Mitrovica, Peja dhe Prizreni. Pjesa e analizës cilësore bazohet në realizim të intervistës me fokus grupe ku janë përfshirë inspektorë të arsimit, drejtorë shkollash, pedagogë dhe psikologë.

Kapitulli i katërt, paraqet të dhënat e mbledhura nga studimi empirik, analizën e të dhënave dhe rezultatet e tyre. Në këtë kapitull diskutohen edhe rezultatet sasiorë, edhe ato cilësore të hulumtimit, që nënkupton se kemi metoda të kombinuara. Në analizën e të dhënave të fituara nga metodat sasiorë, janë përcaktuar analiza korrelacionale, Koeficienti i Pearson-it, analizën e ANOVA's dhe post hoc-test për efikasitetin dhe zbatueshmërinë e komponentës së vlerësimit të nxënësve sipas kurrikulës bazuara në kompetenca, T-testi për grupet e pavarura u përdor për të matur diferencat në lidhje me kualifikimin shkollor, përvojën në arsim, nivelin e arsimit, dhe qëndrimin e mësimdhënësve mbi dallimet e sistemit të vlerësimit të nxënësve sipas kurrikulës bazuar në objektiva dhe atë me kompetenca, të mësimdhënësve meshkuj e femra.

Kapitulli i pestë, ofron diskutimin e rezultateve të cilin synon të evidentojë realizimin e qëllimit të këtij studimi, lidhur me sistemin e vlerësimit të nxënësve në Kosovë sipas kurrikulës bazuar në objektiva dhe në kompetenca, si dhe të hipotezave të ngritura në studim. Ky kapitull prezanton diskutimet mbi rezultatet që kanë dalë përmes analizës për çështjet kryesore të studimit, anketës me anë të pyetësorit me mësimdhënës dhe protokollit të intervistave me

trajnerë për zbatimin e kurrikulës, inspektorë të arsimit, drejtorë shkollash, pedagogë dhe psikologë.

Kapitulli i gjashtë, jep përfundimin dhe rekomandime të cilat adresohen deri tek MASHT-i dhe DKA, institucionet shkollore dhe mësimdhënësit, duke shprehur dhe nevojën për kërkime të mëtejshme.

Kapitulli i shtatë, ofron referencat e përdorura në krijimin e këtij punimi. Konkretisht, është përfshirë një bibliografi e plotë në formatin APA.

Kapitulli i tetë, ofron shtojcat e referuara në këtë punim. Kjo përfshinë: pyetësorin për mësimdhënësit, si dhe intervistën me fokus grupe.

Përshkrim i shkurtër i metodave të përdorura:

Gjatë hartimit të këtij punimi doktrate, me titull “**Sistemi i vlerësimit të nxënësve në Kosovë sipas kurrikulës bazuar në objektiva dhe në kompetenca**” kandidati i është përmbajtur respektimit të standardeve metodologjike në punën kërkimore-shkencore.

Në këtë studim kandidati përmes hulumtimeve cilësore në teren është përpjekur të kuptoj perceptimin e mësimdhënësve në lidhje me sistemin e vlerësimit të nxënësve në Kosovë sipas kurrikulës bazuar në objektiva dhe në kompetenca. Ai ka mbledhur informacione nga një larmi individësh dhe cilësimesh, duke përdorur teknika të shumta të mbledhjes së të dhënave për të kontrolluar rezultatet e tij. Kandidati ka përdorur dhe një intervistë në fokus grupe në përpjekje për të marrë mendimet e tyre. Ai ka siguruar të dhëna, të cilat i ka shfrytëzuar për studimin e tij; fillimisht ka përdorur teknikat e marrjes së mostrave dhe rekrutimin e pjesëmarrësve, duke respektuar sidomos kriterin e rastësisë. Pastaj përshkruan metodat dhe instrumentet e hulumtimit, burimet e të dhënave, përfshirë strategjitë e anketimit të pjesëmarrësve dhe të dhënat sasiore. Përmes programit statistikor SPSS ka analizuar të dhënat që ka siguruar gjatë hulumtimit, ndërkaq për matjen e besueshmërisë, është bërë analiza e koeficientit të Alfës së Kronbahut (Cronbach's Alpha).

Përshkrim i shkurtër i rezultateve të hulumtimit:

Tema e doktoratës “**Sistemi i vlerësimit të nxënësve në Kosovë sipas kurrikulës bazuar në objektiva dhe në kompetenca**”, përbën një përpjekje nga ana e kandidatit për të hulumtuar dhe arritur në përfundim se ekzistojnë dallime të theksuara në mes të vlerësimit të

nxënësve sipas kurrikulës bazuar në objektiva dhe asaj në kompetenca, se zbatueshmëria e rrit efikasitetin e komponentës së vlerësimit të nxënësve sipas kurrikulës bazuar në kompetenca, se përvoja në arsim nuk ka ndonjë rol të theksuar në efikasitetin dhe zbatueshmërinë e komponentës së vlerësimit të nxënësve sipas kurrikulës bazuar në kompetenca, se nuk kemi dallime gjinore sa i përketë efikasitetit, ndërsa mësimdhënëset femra kanë zbatueshmëri më të lartë të komponentës së vlerësimit të nxënësve sipas kurrikulës bazuara në kompetenca, se moshat e reja kanë më tepër zbatueshmëri të komponentës së vlerësimit të nxënësve sipas kurrikulës bazuar në kompetenca, sesa moshat e vjetra.

Kontributet kryesore shkencore të kandidatit:

Tema të cilën e ka punuar kandidati i takon periudhës së afërt prandaj, nuk është trajtuar gjerësisht nga studiuesit deri tani. Ky studim do të shërbej si nxitje në të ardhmen që kjo temë të hulumtohet më gjerësisht nga studiues të tjerë.

Kandidati ka shfrytëzuar burime relevante, të cilat e bëjnë temën të rezistueshme nga kritikant shkencore. Ai ka bërë krahasim të burimeve të ndryshme, të cilave u është qasur në mënyrë shkencore. E veçanta e kësaj teme qëndron në faktin se nga ky studim dolën në sipërfaqe një numër i konsiderueshëm i të dhënave dhe gjetjeve, të cilat tregojnë se ka mjaft zhvillime dhe praktika pozitive në zbatimin e sistemit të vlerësimit të nxënësve sipas kurrikulës bazuar në kompetenca në krahasim me atë në objektiva. Të dhënat e studimit nxoren në pah mjaft sfida dhe probleme, të cilat duhet të adresohen. Prandaj, mund të konkludojmë se të gjeturat e këtij studimi mund të shërbejnë për të ndërmarr hapa dhe masa të mëtutjeshme nga institucionet të cilat janë pjesë e hartimit të strategjive mësimore, si dhe institucionet zbatuese siç janë komunat dhe shkollat për zbatim të suksesshëm të komponentës së vlerësimit.

Hulumtime të mundshme në të ardhmen:

Tema e doktoratës “Sistemi i vlerësimit të nxënësve në Kosovë sipas kurrikulës bazuar në objektiva dhe në kompetenca” është e gjerë dhe brenda saj janë trajtuar çështje të ndryshme, çka jep mundësi që në të ardhmen kandidati ose studiues të tjerë të trajtojnë çështje të veçanta.






Kandidati ka bërë përpjekje për të dhënë pasqyrë sa më të plotë të ngjarjeve, të cilat lidhen me temën e vlerësimit të nxënësve, ku si çështje që mund të trajtohen në të ardhmen janë

ritja e përkushtimit institucional për të vazhduar zbatimin e reformave lidhur me komponenten e vlerësimit të nxënësve sipas kurrikulës bazuar në kompetenca, përforcimi i kapaciteteve profesionale të mësimitdhënësve për zbatimin e komponentës së vlerësimit të nxënësve sipas kurrikulës bazuar në kompetenca, si dhe parimeve që e udhëheqin vlerësimin e nxënësve bazuar në kurrikulën me kompetenca, siç janë: transparenca, vlefshmëria, besueshmëria dhe paanshmëria.

Vlerësim dhe rekomandim:

Nisur nga vlerësimet e mësipërme Komisioni shkencor për vlerësimin e dorëshkrimit të temës së doktoratës “Sistemi i vlerësimit të nxënësve në Kosovë sipas kurrikulës bazuar në objektiva dhe në kompetenca”, të kandidatit Mr. sc. Hysen Balaj, ka nderin që t’i propozoj Këshillimit mësimit-shkencor të Fakultetit Pedagogjik miratimin e këtij raporti dhe krijimin e kushteve për mbrojtjen publike të kësaj teme të doktoratës.

Komisioni:

1. Prof. Dr. Lulzim Mehmedi, ;
2. Prof. Dr. Besa Havziu-Ismaili, ;
3. Prof. Dr. Svetlana Pandiloska-Grnçarovska, ;
4. Prof. Dr. Buniamin Memedi, ;
5. Prof. Dr. Fadbi Osmani, .

Tetovë,

18.07.2023